



Dalës-lizazna

Nr. I-38

Br.

Data

Datum

18.03.2019



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt. 26.03.2019, ( e martë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

## R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës, nismën për bashkëpunim ndër komunal/at ( Komunës së Prishtinës, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Vushtrrisë ) në fushën e infrastrukturës fizike
4. Shqyrtimi i planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019
5. Shqyrtimi i raporteve përfundimtare të Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunal në shfrytëzim :
  - a) Raporti me nr V-188 , datë:22.02.2019
  - b) Raporti me nr V-187 , date :22.02.2019
6. Shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së
7. Shqyrtimi i kërkesës së MAPL-së ( rishikimi i vendimit nr. 203 dt.28.12.2018 )
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit

Burim Gërguri





Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.20.2.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm janë këta anëtarë:** Burim Gërguri, Florije Jashari, Linda Sadiku, Hysni Mjeku, Qëndresa Dubova, dhe Slavisa Spasic

**Të pranishmit tjerë:** Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH, Agim Spahiu, drejtor i DKA-s ë, përf.i OSBE-së, përf.i KFOR-it, përf. i IZHL-së dhe përf e shoqërisë civile

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2018
4. Shqyrtimi i Raportit të Zyres së Personelit për vitin 2018
5. Shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së, për objektet “D dhe GJ”
6. Dhënia në diskutim publik e Draft Rregullore për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore
7. Dhënia në diskutim publik e Draft Rregullore për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale
8. Propozim Vendimi për rritjen e të hyrave vetanake dhe bartja e mjeteve buxhetore nga viti 2018 në vitin 2019
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

**Burim Gërguri** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës, i cekur më lartë.

**1.Pika e parë e rendit të ditës** –

**Mungoi:** Fatos Kurshumlija me arsye

**2.Pika e dytë e rendit të ditës** –

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

**3.Pika e tretë e rendit të ditës**

**Burim Gërguri** – Në raportin e Zyres të Kryetarit të Komunës, është përfshirë raporti i Ekzekutivit, raporti i Zyres së Personelit dhe raporti i Zyres së Prokurimit. Mirëpo, për shkak të kërkesës për transparencë të plotë jemi detyrue me nda në mënyrë të veçantë raportin e Zyres së Personelit nga ai i Zyres së Kryetarit. Unë e falenderoj Ekzekutivin në krye me Kryetarin e Komunës, që e kanë sjellë një raport ndoshta pak voluminoz, por përmbajtësor i aktiviteteve që janë bërë për vitin 2018.Tani, dua ta pyes drejtoreshën sa janë tejkaluar të hyrat vetanake dhe shpenzimet e investimeve kapitale.



**Zarife Behluli** – Përgjegjet se sa i përket planifikimit të të hyrave vetanake për vitin 2018, kanë qenë të planifikuara me buxhet 876,728 euro, janë realizuar 1 milion e 10 mijë e 447.26, tejkalim kemi 133,719.26, që është 115 % realizimi i të hyrave vetanake nga planifikimi dhe tejkalimi i të hyrave vetanake. Ndërsa, realizimi i projekteve kapitale është 67 %.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

#### **REKOMANDIM**

**I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2018.**

**Pika e 4 e rendit të ditës**

**Burim Gërguri** – Ju thashë në fillim se ishte kërkesa që raporti i Zyres së Personelit të jetë në mënyrë të veçantë, atëherë edhe e kemi përfshi si pikë në rend të ditës. Nëse, nuk ka ndonë diskutim prej juve, atëherë e rekomandojmë për Kuvend.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

#### **REKOMANDIM**

**I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim Raporti i Zyres së Personelit për vitin 2018.**

**Pika e 5 e rendit të ditës**

**Burim Gërguri** – Është një kërkesë e kahershme që e kemi pasë edhe në muajin nëntor dhe janë rekomandimet e 2 ose 3 viteve, rresht të zyres kombëtare të auditimit dhe të auditorit të brendshëm për çështjen e pazgjidhur të objekteve “D dhe GJ”. Propozoj që Kuvendi bashkë me Ekzekutivin ta formoj një Komision i cili do ta verifikoj gjendjen faktike dhe të vjen me një raport final në mënyrë që të bëhet një zgjidhje finale për të gjitha ato lokale afariste, të cilat ende nuk kanë një tretman të trajtuar.

**Hysni Mjeku** – Unë nuk e di se auditorit a ju ka parashtrur vendimi i Kuvendit komunal, po flas për lokalet e subjekteve politike. Unë kam një kërkesë që ato lokale të cilat ju kanë dhënë subjekteve politike vërtetë të legalizohen, që për momentin aty është LDK-ja, PDK-ja, ka qenë e paraparë edhe AAK-ja, por në ndërkohë ajo nuk di se për çfarë arsye është tërheqë. Mendoj se subjektet që e kryejnë veprimtarinë aty duhet t’ju lëshohet vendimi ose duhet të legalizohen me kontratë ose me ju dhënë një tretman i veçantë sepse fundi i fundit ne jemi për atë që ti marrim taksat prej tyre.

**Burim Gërguri** - Unë jam dakord që ky problem të adresohet saktë dhe propozoj të formohet Komisioni prej Ekzekutivit dhe anëtarëve të Kuvendit, duke përfshi edhe rekomandimet e zyres kombëtare të auditorit me vërejtjet që i kanë dhënë dhe këtë problem me zgjidhë njëherë e përgjithmonë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

#### **REKOMANDIM**

**I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim kërkesa e DSHPE-së nr.VI-30, e dt.22.01.2019, dhe formimi i Komisionit komunal (miks) për trajtimin e çështjes.**

**Pika e 6 e rendit të ditës**

**Burim Gërguri** – Ju e dini se kjo është një kërkesë që Draft Rregullorja për ndarjen e bursave të dalë në debat publik, që të kryhen procedurat tjera pas debatit publik dhe të trajtohet në mbledhjen e radhës të KPF-së, pastaj në Kuvend.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

#### **REKOMANDIM**

**I rekomandohet Kuvendit komunal për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktivitetëve jashtëshkollorë.**

**Pika e 7 e rendit të ditës**

**Burim Gërguri** - Unë e pashë se ishte një kërkesë e Ministrisë së financave dhe harmonizimi i të gjitha akteve normative në nivel të vendit duke përfshirë edhe Rregulloren e tatimit në pronë. Në këtë vit për së pari herë fillojnë të taten edhe tokat, që besoj se kjo do të futet në Draft Rregulloren e re për aprovim.

**Zarife Behluli** – Sa i përket Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba, është në nivel të të gjitha Komunave që nesër është caktuar një takim në Durrës me zyrtarë ligjor dhe Ministria e financave, për me bë një



Rregullore unike për të gjitha Komunat. Poashtu, edhe ne ato që kemi me i ndryshue do ti paraqesim në Rregullore, në mënyrë që të bëhet një Rregullore finale.

**Burim Gërguri** – Unë e pyes drejtoreshën se njoftimet për obligimet a do të shkojnë sipas Rregullores që është në fuqi, apo do të pritet vendimi për Rregulloren e re.

**Zarife Behluli** – Përgjegjet se derisa është në fuqi Rregullorja vazhdon të zbatohet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

#### **REKOMANDIM**

**I rekomandohet Kuvendit komunal për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.**

**Pika e tetë e rendit të ditës**

**Zarife Behluli** – Siç ju thashë më heret nga planifikimi i të hyrave vetanake 876,728 euro, janë realizuar 1 milion e 10 mijë e 447.26. Nga kjo rritje e mjeteve janë alokuar me vendim të Kuvendit 36,151.87 qysh në vitin 2018, ndërsa për alokim në vitin 2019 janë 97,567.39. E keni tabelën e projekteve, ka disa transfere dhe rialokime, mbetje të projekteve që nuk vazhdojnë të cilat i kemi paraparë me i transferue në projektet tjera psh rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara, mbjellja e drunjëve janë 29,168, rregullimi i varrezave dhe mirëmbajtja 2,052.20, inventarë për QKMF, 2,395, ndërtimi i objektit në QKMF Milloshevë 947.92, rregullimi i objekteve, QMF, AMF 1,564.80, renovimi i shkollave dhe blerja e pajisjeve 2,500, renovimi i infrastrukturës së shkollave 1,193.58, transferohen në rregullimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, totali 39,821.50. Ndërsa, në bashkëfinancim kalojnë këto projekte: ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës shkollore 5,493.59, renovimi i shkollave 4,505.59, ndërtimi i objektit ndihmës në QKMF 4,375.62, blerja e inventarit 1001.28, ndërtimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të qytetit 8,353.68, pajisje mjekësore për QKM 6,848.50, që në total 30,570.26, kalojnë në vijën e bashkëfinancimit. Mallrat nga mbetjet e Drejtorive 7,02.09, shtruarja e rrugëve me zhavorr 21,861 kalon në mallra ndërsa, në shpenzime komunale nga mbetjet e Drejtorive, 818.54 si dhe nga rritja e të hyrave 52,567.39 kalojnë në DSHPE. Në total i bjen 706,753.09, bëhet bartja e mjeteve nga viti 2018 në vitin 2019.

**Burim Gërguri** - Këto, mjete kalojnë në DSHPE për obligime komunale për rrymë, ujë dhe mbeturina.

**Zarife Behluli** – Po, ashtu është për shpenzime komunale rrymë, ujë dhe mbeturina.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

#### **REKOMANDIM**

**I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Propozim Vendimi:**

**a) për rritjen e të hyrave vetanake dhe**

**b) bartjen e mjeteve buxhetore nga viti 2018 në vitin 2019.**

**Pika e nëntë e rendit të ditës**

**Burim Gërguri** – E kemi një kërkesë nga viti 2018, nga Esat Berisha nga Millosheva me ç'rast pensionistët e Milloshevës kërkojnë që anëtarët e Kuvendit komunal, ta votojnë për dhënien në shfrytëzim të objektit të ish ambulancës së vjetër për shoqatë të pensionerëve të Milloshevës.

**Ibush Mjekiqi** - Unë besoj se brenda këtij muaji dhe eventualisht muajit tjetër do të mbyllet ky proces dhe ekzistojnë procedurat tjera dhe kërkesa mund ti kthehet atij që nuk dmth me u marrë vendim dhe me u aprovue gjithsesi. Është procedurë standarde që do të vjen në Kuvend dhe do të kërkohet prej Kuvendit që të lirohet Drejtoria e shëndetësisë prej menaxhimit të atij objekti dhe ti kalohet DKRS-së, pastaj me vendim të veçantë ti ndërrohet karakteri. Ne kemi menduar që një pjesë e atij objekti ti jipet pensionistëve, ndërsa pjesa tjetër sportistëve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

#### **REKOMANDIM**

**I rekomandohet DSHMS-së, për shqyrtim kërkesa nr.I-32944, e dt.17.12.2018.**

**Burim Gërguri** – Paraqet kërkesën nga Bashkim Ismaili, nga Llazareva i cili kërkon të shqyrtohet çështja e një parcele, në mënyrë që të bëhet zgjidhje edhe për fqinun e tij dhe për rrugën.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:



## REKOMANDIM

I rekomandohet DPUKP-së , për shqyrtim kërkesa me nr.I-1574, e dt. 21.01.2019 nga Bashkim Ismaili nga fshati Llazarevë.

**Burim Gërguri** – Paraqet kërkesën nga Kryetari i Komunës, Propozim Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në Obiliq.

**Hysni Mjeku** – Kjo çështje është trajtuar që nga viti 2007, dhe jorastësisht kam qenë pjesë e këtij Kuvendi dhe këtij Komiteti dhe e kam quajtur këtë pjesë kalkutë e Obiliqit. Unë e përgëzoj Kryetarin për një vendim dhe guxim të jashtëzakonshëm dhe ne si anëtarë të Kuvendit komunal dhe Komitetit duhet ti japim shtytje. Mua, më intereson kostoja e këtyre shpronësimeve, që nuk e di se drejtoresha e financave a ka bërë ndonjë parallogari për me ditë se sa kushton. Mirëpo, a është imperativ i kohës, është më se i domosdoshëm sepse është një pasqyrë e shëmtuar, kështu që këtë vit dhe vitin e ardhshëm kjo çështje duhet të rregullohet dhe ti jipet një pasqyrë e vërtetë që i ka hije një qyteti. Unë jam pro këtyre vendimeve dhe jam për atë që sa më shpejtë të ekzekutohen.

**Burim Gërguri** – Besoj se kosto nuk do të ketë sepse objektet që janë montazhë të ndërtimit për shkak të obligimeve komunale, që i kanë pasë për shumë vite nga shfrytëzimi i hapësirës apo të tatimit në pronë nuk kanë arritë me i obligue, përkundrazi ata kanë me pasë obligime ndaj Komunës, e jo Komuna ndaj tyre.

Vlerësimet i bën Ministria për kompensim, por ne po hapim rrugë që ajo zonë të shpallet me interes publik Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota “Për” dhe 1 votë “Abstenim” morën këtë:

## REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelat në ZK në Obiliq.

**Burim Gërguri** – Paraqet përgjegjen nga DPUKP, për kërkesën e Xhevdet Mjekiçit lidhur me emërtimin e një rruge.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

## REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për aprovim përgjegja nga DPUKP për kërkesën nga Xhevdet Mjekiçi për emërtimin e rrugës së re afër rrugës “Haxhi Hasani” (kërkesë e rekomanduar nga mbledhja e KPF-së, e dt.25.1.2019).

**Pika e 10 e rendit të ditës**

**Burim Gërguri** – Meqë, nuk kemi asgjë për të diskutuar në këtë pikë të rendit të ditës, atëherë edhe e përfundojmë mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00’

Bashk.prof.për punë të KK-së

  
Azize Zeneli

